



Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren

Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR						
Niveli i studimeve	katërvjeçar	Programi	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	Viti akademik	2021/2022	
Lënda:	Fonetikë e gjuhës shqipe me fonologji II					
Viti	1	Statusi i lëndës	obligative	Kodi		ECTS kredi
Semestri	II					5
Javët mësimore	15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime
					2	2
Metodologjia e mësimimit	Gjatë realizimit të orës praktikohet metodologjia interaktive, duke e bërë studentin pjesëmarrës aktiv jo vetëm në ushtrime, por edhe në ligjërata					
Konsultime						
Mësimdhënës:	Prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj		e-mail	xhafer.beqiraj@uni-prizren.com		
			Tel.	+383 (0)44 950 - 369		
Asistent:						

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë drejt objektin studimor të fonetikës dhe të fonologjisë së shqipes, të cilat kanë për objekt studimi tingullin dhe fonemën, dhe veçritë e tyre; - të njohin aparatën e të folurit dhe strukturën e ndërtimit të tij; - të sigurojnë njohuritë e nevojshme e të përgjithshme të sistemit tingullor dhe të sistemit fonemor; - të fitojnë njohuri për sistemin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, qoftë në aspektin nyjetimor, qoftë në atë akustik dhe klasifikimin e tyre; - të fitojnë njohuri për konceptet e fonetikës dhe të fonologjisë; - të njohin sistemin tingullor një nga disiplinat kryesore gjuhësore, krahas gramatikës dhe semantikës, që ka si objekt studimi sistemin tingullor të gjuhës. Fonetika do t'u ndihmojë studentëve të studiojnë dhe të përvetësojnë njohuritë jo vetëm për 	<p>Pikësynimi kryesor i lëndës (në fund të këtij kursi) është që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohin objektin studimor të fonetikës, sistemin tingullor të gjuhës (veçoritë e zanoreve dhe bashkëtingëlloreve dhe klasifikimin e tyre; - t'i njohin mirë ndryshimet historike të tingujve (zanoreve dhe bashkëtingëlloreve); - t'i njohin ndryshimet e tingujve në rrjedhën e ligjëritimit: asimilimin, disimilimin, elizionin, epentezën, aferezën, sinkopën, apokopën etj.; - t'i njohin mjaft mirë çështjet prozodike, si: rrokjen, theksin, intonacionin; ndarjen e fjalëve në rrokje etj.; - të kenë fituar njohuri për drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin; - t'i kuptojnë prirjet e përgjithshme të zhvillimit të fonetikës bashkëkohore; - të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e fituara nga fusha e fonetikës; - të aftësohen për punë kërkimore-hulumtuese: individuale e grupore.

<p>sistemin tingullor, por edhe aspektet fiziologjike dhe akustike të sistemit tingullor të gjuhës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë ndërtimin dhe funksionimin e aparatit të folurit, dhe ndarjen e tingujve në zanore dhe bashkëtingëllore dhe veçoritë e tyre fonetike dhe akustike; - të kuptojnë sa më mirë ndryshimet historike të fonemave (zhvillimet fonetike) të zanoret dhe bashkëtingëlloret; modifikimet e tingujve në rrjedhën e ligjërimit: asimilim, disimilim, epentezë, sinkopë, apokopë etj. - të kuptojnë ndarjen e fjalëve në rrokje, theksin, intonacionin etj.; -t'i zhvillojnë aftësitë për të hulumtuar, krahasuar, analizuar, sintetizuar etj. 	
--	--

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:																			
<p>ECTS-sistemi europian i transferimit dhe procesi i akumulimit të kredive, është një sistem i orientuar kah studenti dhe paraqet vleftën e ngarkesës së tij për të arritur objektivat e një lënde (kursi) ose programi të caktuar të studimit.</p> <p>Ngarkesa e studentit sipas ECTS bazohet në kohën që nevojitet për t'i kompletuar aktivitetet e planifikuara rreth një lënde (kursi), siç janë: pjesëmarrja në ligjërata, aktiviteti dhe pjesëmarrja në ushtrime, puna në terren, përgatitja e projekteve dhe plankonspekteve, prezantimet dhe mbajtjet e orëve, punime seminarike, punë konsultative me mentorin, puna e pavarur në bibliotekë ose në shtëpi, përgatitja përfundimtare e provimit, koha e kaluar në provim dhe parametra të tjerë.</p>																			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:																			
Tabela, shkumësi, laptopi, projektori etj.																			
Mënyra e vlerësimit të studentit:																			
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi</th> <th>Nota përfundimtare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>90% - 100%</td> <td>10 (dhjete)</td> </tr> <tr> <td>81% - 90%</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>71% - 80%</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>61% - 70%</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>51% - 60%</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>50%</td> <td>5 (pesë)</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Vlerësimi	Nota përfundimtare	90% - 100%	10 (dhjete)	81% - 90%	9 (nëntë)	71% - 80%	8 (tetë)	61% - 70%	7 (shtatë)	51% - 60%	6 (gjashtë)	50%	5 (pesë)				
Vlerësimi	Nota përfundimtare																		
90% - 100%	10 (dhjete)																		
81% - 90%	9 (nëntë)																		
71% - 80%	8 (tetë)																		
61% - 70%	7 (shtatë)																		
51% - 60%	6 (gjashtë)																		
50%	5 (pesë)																		
Obligimet e studentit:																			
<p>Ligjërata Studentët kanë për detyrë të ndjekin rregullisht ligjëratat. Në mënyrë ndërvepruese të marrin pjesë në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe t'i kryejnë</p>	<p>Ushtrime Studentët kanë për detyrë të marrin pjesë aktive në orët e ushtrimeve. Për çdo paqartësi që kanë me materien e lëndës mësimore, të konsultohen me</p>																		

të gjitha angazhimet që i jep mësimdhënësi.	mësimdhënësin. Gjatë semestrit të bëjnë një punim seminarik, me parapëlqim që ai të prezantohet me Power Point në klasë, të hyjnë në dy testet (gjysmësemestral) dhe së fundmi t'i nënshtrohen provimit përfundimtar		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata:	2	15	30
Ushtrime teorike:	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet:	1	15	15
Punime seminarike:	2	4	8
Koha e studimit të pavarur në biblioteka:	2	15	30
Detyra të shtëpisë:	1	5	15
Projekte, prezantim:	1	4	4
Përgatitja përfundimtare për provim:	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim përfundimtar):	2	2	4
Vërejtje: Po qe se vlefta e 1 ECTS kredie është 25 orë, atëherë rezulton se për ta përgatitur provimin e lëndës së <i>Fonetikës</i> , studentit i duhen 125 orë punë. Kjo del edhe kur 125 orë pjesëtohen me 25, rezulton se lënda ka vleftë prej 5 kredish.	Ngarkesa totale:		125

Jav a	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	Orët	Tema	Orët
1.	Përsëitje lidhur me konceptet fonetike dhe fonologjike: tingull, fonemë, kundërvënie, seri, radhë etj.	2	Ushtrime lidhur me drejtshqiptimin e tingujve	2
2.	Ndërrimi i zanoreve: metafoni, apofoni Dukuria e nazalizmit	2	Ushtrime lidhur me ndërrimin e zanoreve	2
3.	Ndërrimi i bashkëtingëlloreve: palatalizim, rotacizëm, elizioni, kontraksioni, krasisi dhe ndërrimet e tjera: rr-r, s-t, t-s	2	Ushtrime për ndërrimet e tingujve bashkëtingëllorë	2
4.	Njësitë metrike dhe dukuritë prozodike, rrokja	2	Ushtrime – Prozodia: rrokja	2
5.	Ndarja fonetike e fjalëve në rrokje dhe ndarja në rrokje në kufij morfemash dhe	2	Ushtrime për rrokjen	2

	fjalësh			
6.	Theksi i fjalës	2	Ushtrime lidhur me theksin e shqipes	2
7.	Vendi i theksit	2	Ushtrime për vendin e theksit në shqipe	2
8.	Shkallëzimi i theksit, këmba fonetike, fjala fonetike.	2	Test gjysmësemestral I	2
9.	Rrjeta metrike, grupi kuptimor, fraza dhe intonacioni.	2	Ushtrime për rrjetën metrike, grupin kuptimor dhe intonacionin	2
10.	Funksionet e intonacionit: funksioni dallues, aktualizues dhe funksione të tjera	2	Ushtrime lidhur me funksionet e intonacionit	2
11.	Drejrtshkrim: Norma fonetike e shqipes		Ushtrime	2
12.	Drejrtshqiptimi dhe drejrtshkrimi	2	Ushtrime	2
13.	Rregullat e drejrtshqiptimit të zanoreve	2	Ushtrime për drejrtshqiptimin e zanoreve	2
14.	Rregullat e drejrtshqiptimit të bashkëtingëlloreve	2	Ushtrime	2
15.	Sistemi grafik i gjuhës	2	Test gjysmësemestral II	2

LITERATURA

Memushaj, R., *Fonetika e gjuhës standarde*, Toena, Tiranë, 2010.
Bahri B., *Fonetika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.

Vërejtje. Nuk do të ketë asnjë tolerancë për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjashme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

Vërejtje për studentin:

Studentët duhet t'u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve e vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe Këshilli Mësimor.

Pritet që secili student të vijë me kohë.

Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjëratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është e nevojshme (e domosdoshme). Çdo mungesë e vazhdueshme rezulton me zbritjen e notës përfundimtare. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.